



VENDIM
I GJYQARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me daten **01. 03. 2021**, une gjyqtari i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane **Ervin Pollozhani** pasi studiova kerkesen dhe materialet e paraqitura nga z. Vojo Malo, shtetas shqiptar, i biri i Syrjait, dtl. 20.03.1958, lindur dhe banues ne Tirane, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i ID me Nr. F80320340E, ne cilesine e zv. Presidentit dhe Presidentit ne Detyre te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH),

KONSTATOVA:

Se, fillimisht kjo kerkese eshte paraqitur ne gjykate me dt. 01. 02. 2021 referuar vules se depozitmit dhe eshte shortuar ne dt. 02. 02. 2021 prane nje tjetër trupi gjykues. Ky i fundit rezulton se me dt. 04. 02. 2021 ka paraqitur kerkese per heqje dore nga shqyrtimi i kesaj çështje e cila eshte pranuar si e tille nga Zv. Kryetari i gjykates po ne dt. 04. 02. 2021, eshte shortuar po ne dt. 04. 02. 2021 tashme prane trupit te ri gjykues dhe eshte paraqitur nga kryesekretaria prane ketij trupi te ri gjykues vetem me dt. 08.02.2021.

Pasi jam njohur me kerkesen dhe aktet shoqeruese, rezultojne si rrethana fakti sa me poshte shpjegohet :

Me vendimin Nr. 5934 dt. 22. 06. 2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar si Person Juridik ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese, Shoqata: « KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR ».

Referuar ketij vendimi dhe akteve qe kane sherbyer per regjistrimin e tij (statuti) se organet drejtuese te kesaj shoqate jane: Asambleja e Pergjithshme si organ vendimmarres, Komiteti Ekzekutiv, si organ ekzekutiv, Presidenti dhe zv. Presidenti.

Menyra e organizimit, funksionimit dhe kompetencat e ketyre organeve jane percaktuar qarte ne statutin e shoqates.

Nga ana tjetër referuar akteve rezulton se anetare te KOKSH-it jane gjithsej: *39 Federata* te nominuara sipas listes bashkangjitur akteve ku eshte cituar vetem Nr. Vendimit gjyqesor dhe data e regjistrimit si OJF ne gjykate pa specifikuar emrin e Presidentit, *6 Komitete Olimpike* ku eshte cituar vetem Nr. Vendimit gjyqesor dhe data e regjistrimit si OJF ne gjykate pa specifikuar emrin e Presidentit/Kryetarit, *3 Shoqata* ku eshte cituar vetem Nr. Vendimit gjyqesor dhe data e regjistrimit si OJF ne gjykate pa specifikuar emrin e Kryetarit/Presidentit dhe *9 Anetare me Titull individual* (te nominuar specifikisht secili prej tyre).

Selia e shoqates eshte ne Tirane me adrese Rruga "Muhamet Gjolllesha", Sheshi "Mustafa K. Atatürk", Tirane.

Me cilesine e Presidentit te kesaj shoqates eshte zgjedhur z. Viron Bezhani, ndersa me cilesine e zv. Presidentit eshte zgjedhur z. Vojo Malo qe jane dhe anetare te Komitetit Ekzekutiv.

Me cilesine e Mbajtesit te Thesarit eshte zgjedhur z. Genc Boga qe eshte dhe anetar i Komitetit Ekzekutiv dhe me cilesine e 8 anetareve te tjera jane zgjedhur z. Agron Cuka, zj. Ela Tase, z. Erlind Pellumbi, z. Ilir Gusho, z. Koço Mikerezi, z. Labo Çobo, zj. Majlinda Pilinci dhe z. Renis Teršana.

Ne vijimesi ka rezultuar se me kerkese te 2/3 (dy te tretave) te anetareve me te drejte vote te anetareve te Asamblese se KOKSH, ne perputhje me parashikimet statutore te KOKSH, ne dt. 10 Janar 2021 ne Tirane eshte zhvilluar Asambleja e 23-te e Pergjithshme e Jashtzakonshme e KOKSH, fillimisht me rend dite: 1. Shkarkimi i Presidentit Aktual te KOKSH, z. Viron Bezhani. 2. Miratimin e ndryshimeve statutore sipas draft-statutit te hartuar nga Komiteti Teknik dhe te derguar anetareve te KOKSH nga Sekretariati i KOKSH qe ne dt. 20 Tetor 2020, 3. Percaktimi i hapave te metejshem per zhvillimin e Asamblese Zgjedhore.

Kerkesa eshte paraqitur formalisht me dt. 13. 12. 2020 e nenshkruar nga 56 anetare, referuar ne Nenin 15 pika 1 dhe 2 e Statutit te KOKSH, e protokolluar me Nr. 226 Prot. dt. 15.12.2020 dhe i eshte drejtuar Komitetit Ekzekutiv te KOKSH, per dijeni Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise, Komitetit Olimpik Nderkombetar.

Sipas dispozitave statutore referuese, perkatesisht Nei 15 i saj percaktohet se: "Asambleja e Pergjithshem e Jashtzakonshme mund te thirret me kerkesen e Presidentit te KOKSH-it ose me kerkesen me shkrim te 2/3 te anetareve qe kane te drejte vote. Mbledhja zhvillohet brenda nje muaji nga data e dorezimit te kerkeses ne Komitetin Ekzekutiv.

2. Asambleja e Pergjithshme e Jashtzakonshme vendos per ndryshimin e statutit te KOKSH si dhe per ceshtje te tjera me rendesi te veçante dhe qe kerkojne vendimmarrje te shpejte".

Rezulton sipas akteve se Komiteti Ekzekutiv, pasi eshte njohur me kerkesen e 2/3 te anetareve me te drejte vote per thirrjen e Asamblese se Jashtzakonshme te KOKSH ne date 15/12/2020 (e-maili bashkangjitur se bashku me kerkesen), per shkak te pandemise dhe kohes se shkurter ne dispozicion, ka qarkulluar me e-mail mendimet e anetareve dhe ka miratuar me shumice votash propozimin e Zv. Presidentit Z. Malo, duke vendosur ne date 22/12/2020 qe Asambleja e Jashtzakonshme e KOKSH te zhvillohet ne daten 10 janar 2021. Keshtu sipas vendimit qarkullues te dt. 22. 12. 2020 te Komitetit Ekzekutiv te KOKSH eshte vendosur:

1. Te caktoje daten 10 Janar 2021 si dita per zhvillimin e Asamblese se Jashtzakonshme te kerkuar nga me shume se 2/3 e anetareve te saj me kete rend dite:

- a) Shkarkimi i Presidentit aktual te KOKSH, z. Viron Bezhani.
- b) Miratimin e ndryshimeve statutore sipas draft-statutit te hartuar nga Komiteti Teknik dhe te derguar anetareve te KOKSH nga Sekretariati i KOKSH qe ne dt. 20 Tetor 2020, bashke me tre ceshtjet e diskutueshme;
- c) Zgjidhja e tre anetareve te KVE dhe;
- d) Caktimi i dates se zhvillimit te Asamblese Zgjedhore te KOKSH.

2. Ne lidhje me proceduren e zhvillimit te Asamblese se Jashtzakonshme ajo te kryhet vetem me procedure votimi nese situata e kufizimeve anti-covid nuk do te ndryshoje.

3. Fletet e votimit : a) flete votimi per shkarkimin e Presidentit aktual te KOKSH z. Viron Bezhani; b) Flete votimi per çeshtjet e diskutueshem te draft statutit te punuar nga Komiteti Teknik; c) Flete votimi per miratimin ne teresi te Statutit; d) Flete votimi per zgjidhjen e anetareve te KVE; e) Flete votimi per caktimin e dates se Asamblese Zgjedhore (nese do te jete e nevojshme).

4. Akreditimet do te jene ato qe tashme ishin derguar per Asamblene qe nuk u zhvillua. Ne qofte se do te kete ndryshime, Federatat/Anetaret duhet te njoftojne.

5. Te njoftohet Presidenti z. Bezhani qe me shkrim te shprehi mendimin e tij ne lidhje me kerkesen e anetareve te Asamblese per shkarkimin e tij, mendim i cili ti dergohet anetareve te Asamblese se KOKSH perpara zhvillimit te saj.

Lidhur me shtimin e pikes 1/c te rendit te dites se mbledhjes se Asamblese, kjo pike eshte shtuar ne vendimin qarkullues te Komitetit Ekzekutiv, pasi eshte shtuar si propozim nga anetari dhe zv. Presidenti i KOKSH z. Vojo Malo dhe eshte miratuar nga anetaret, kjo me arsyetimin se do te jete ky Komision qe do te duhet e zgjidhet me qellim qe me pas te kryeje veprimet per asamblete e mepasme zgjedhore, pavaresisht se ne kerkesen e anetareve te asamblese per thirrjen e saj, nje pike e tille e rendit te dites nuk eshte e perfshire.

Pas kesaj vendimmarrje rezulton se eshte proceduar me njoftimin e anetareve te KOKSH-it mbi Asamblene e Jashtezakonshme dhe vendimin qarkullues perkates te siperpermendur. Ky njoftim eshte bere nepermjet formes se zgjedhur tashme me ane te e-maileve te nisur me dt. 26. 12. 2020 te te gjitha anetareve te KOKSH-it te depozituar ne database e mbajtur nga Sekretariati perkates teknik i KOKSH-it.

Me tej rezulton se me e-malin e dt. 05.01.2021 u eshte derguar nje njoftim i dyte anetareve ku eshte percaktuar vendi i zhvillimit te mbledhjes se Asamblese dhe treguar qe do te lejohen te futen vetem personat e akredituar, te cilet duhet te kene mjetet e identifikimit (pasaporte ose karte identiteti) dhe per shkak te rregullave anti-covid duhet te repektojne protokollin perkates (lidhur me largesine apo mbajtjen e maskes, etj).

Rezulton gjithashtu se me emalin e dt. 28. 12. 2020 i eshte derguar Presidentit te KOKSH-it z. Bezhani vendimi qarkullues i marre nga Komiteti Ekzekutiv dt. 22. 12. 2020, ku sipas pikes 5 te tij pare ne raport dhe me piken 1/a te rendit te dites, i eshte kerkuar z. Bezhani qe te shpreh mendimin me shkrim perpara dt. 07.01.2021 ne menyre qe ti dergohet qendrimi i tij formal anetareve te Asamblese se KOKSH-it

Ka rezultuar se me ane te e-mailit dt. 31.12.2020 z. Bezhani ka informuar Komitetin Ekzekutiv lidhur me qendrimin e tij persa i perket menyres te paligjshme dhe ne kundesthim me statutin te thirrjes se kesaj Asambleje te Jashtzakonshme, procedures se ndjekur, falsitetit te nenshkrimeve te anetareve, etj.

Ne vijimesi ka rezultuar se pas ketyre veprimeve paraprake, me dt. 10 janar 2021 eshte mbajtur dhe ka zhvilluar punimet Asambleja e Jashtzakonshme e KOKSH-it. Per kete qellim eshte mbajtur dhe procesverbali perkates ne prezence dhe te noteres zj. Aida Spahiu.

Sipas permbajtjes se tij rezulton se punimet e Asamblese jane drejtuar nga z. Vojo Malo ne cilesine e zv. Presidentit ne kushtet kur Presidenti z. Viron Bezhani ka munguar ne mbledhje edhe pse ka patur formalisht dijeni per te.

Me tej sipas propozimeve te 3 Federatave per emrat e anetareve, eshte zgjedhur Komisioni i Akreditimit dhe Votimit. Ky komision ka qene i perbere nga z. Albens Vokopola, z. Alfred Tahiraj dhe z. Endrit Hoxha, ku me cilesine e kryetarit eshte zgjedhur z. Albens Vokopola.

Sipas procesverbalit te mbajtur nga ky Komision, rezulton se list prezenca ka qene me 40 anetare. Liste akreditimi 39 anetare te cilet perfaqesojne 57 vota.

Kuorumi i nevojshem per zhvillimin e Asamblese se Jashtzakonshme eshte plotesuar me numrin 39 anetare nga 52 ne total (me te drejte vote) te cilet perfaqesojne 57 vota nga 75 ne total.

Ne vijimesi rezulton sipas procesverbalit se ka patur nje propozim per ndryshimin e rendit te dites, dhe konkretisht qe Asambleja te nise me miratimin e draft Statutit dhe me pas me votimin per zgjedhjen e anetareve te KVE dhe shkarkimin e Presidentit aktual z. Viron Bezhani, ku rezulton se me 38 vota pro nga 58 ne total eshte miratuar ky ndryshim i rendit te dites, i cili ne vijimesi ka qene:

1. *Miratimin e ndryshimeve statutore sipas draft-statutit te hartuar nga Komiteti Teknik dhe te derguar anetareve te KOKSH nga Sekretariati i KOKSH qe ne dt. 20 Tetor 2020, bashke me tre çeshtjet e diskutueshme;*
2. *Zgjidhja e tre anetareve te KVE dhe;*
3. *Shkarkimi i Presidentit Aktual te KOKSH, z. Viron Bezhani.*
4. *Caktimi i dates se zhvillimit te Asamblese Zgjedhore te KOKSH.*

Me pas eshte proceduar me pikat e rendit te dites ku sipas permbajtjes se procesverbalit dhe vendimeve te zbardhura me tej, ka rezultuar se per piken e pare te rendit te dites kane votuar me votim te hapur dhe me unanimitet te anetareve te pranishem, per miratimin ne teresi te draft Statutit te paraqitur nga Komiteti Teknik.

E perfshire ne kete pike te pare te rendit te dites, ne Asamble eshte diskutuar çeshtja pare e cila lidhej me faktin nese anetaret me titull individual duhet te jene ne perberje te KOKSH-it si anetare me te drejte vote apo jo sipas kritereve te percaktura ne Nenin 19 pika 1 (g). Ka rezultuar pas diskutimeve se rezultati i votimit ka qene 14 vota pro nga 57 te pranishem me te drejte vote dhe duke qene se keto vota jane me pak se 1/3 e votave te pranishem, propozimi nuk eshte miratuar. Pra Asambleja ka vendosur qe Anetaret me Titull Individual te mos jene anetare me te drejte vote ne Asamblene e KOKSH-it.

Çeshtja e dyte per diskutim lidhej me faktin nese kandidati per President duhet te kete apo jo (ne 5 vitet e fundit) perfshirje ne politike. Ka rezultuar se me 2 vota pro nga 57 ne total nuk eshte miratuar propozimi qe Kandidati per President te mos kete perfshirje ne politike ne 5 vitet e fundit dhe ne kete menyre Asambleja ka vendosur te mos miratoje propozimin dhe te lejoje kandidatet qe jane te perfshire ne politike te kandidojne per postin e Presidentit te KOKSH-it.

Çeshtja e trete per diskutim, lidhej me numrin e votave ne Asamblene e KOKSH-it te shoqatave qe drejtojne nje sport olimpik, pra per faktin nese keto shoqata duhet te kene 2 apo 1 vote ne Asamblene e KOKSH-it, referuar Nenin 19 pika 1 (e). Pas diskutimit lidhur me kete pike referuar procesverbalit

eshte konkluduar se pas votimit ishin 29 vota pro qe shoqata sportive qe drejtojne nje sport Olimpik te kene vetem 2 (dy) vota ne Asamblene e KOKSH-it. Mbeshtetur ne kete deklarim, Asambleja vendosi qe Shoqata Sportive qe drejtojne nje sport Olimpik te kene vetem nje vote ne Asamblene e KOKSH-it.

Lidhur me piken e 2 te rendit te dites. Zgjidhja e tre anetareve te KVE (Komitetit te Verifikimit dhe Etikes) eshte vendosur se me shumice votash jane zgjedhur me kete cilesi: zj. Rovena Golemi (50 vota), zj. Klementina Caushaj (49 vota), z. Reshard Kelliçi (42 vota).

Lidhur me piken 3 te rendit te dites: Shkarkimi nga detyra i Presidentit Aktual te KOKSH-it, z. Viron Bezhani pas votimi ka rezultuar se me 44 (dyzet e kater) vota pro dhe 9 (nente) kunder dhe 1 (nje) vote e pavlefshme, Asambleja e Pergjithshme e KOKSH-it me shumice votash ka miratuar shkarkimin nga detyra te Presidentit aktual te KOKSH-it, z. Viron Bezhani.

Lidhur me piken 4 te rendit te dites: Caktimi i dates se zhvillimit te Asamblese Zgjedhore te KOKSH-it eshte vendosur qe per shkak te procedurave per miratimin e statuteve te ndryshuara prane Komitetit Olimpik Nderkombetar, sipas ligjit per sportin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise dhe faktin qe duhet depozituar edhe ne gjykate, procedura qe zgjasin, data e Asamblese Zgjedhore nuk mund te caktohet dhe per kete te fundit anetaret e Asamblese do te njoftohen nga Komiteti Ekzekutiv i KOKSH-it.

Per te vijuar me tej procedurat per depozitimet perkatese, pergjegjesite e firmes i kalojne zv. Presidentit z. Vojo Malo si President ne detyre i KOKSH-it deri ne Asamblene Zgjedhore te radhes.

Bashkangjitur ketij procesverballi jane procesverbalet e mbajtura nga Komisioni i verifikimit te akreditimeve dhe votimit te mbajtur per çdo pike te rendit te dites ne lidhje me rezultatet e votimit, jane listprezenca e anetareve te akredituar, formularet e akreditimit per secilin anetar me te drejte vote.

Krahas sa me sipër, vlen te theksohet se me Urdherin Nr. 21 dt. 29.01.2021 sipas shkreses Nr. 312/3 Prot. dt. 29.01.2021 te Ministrise se Arsimit, Sportit dhe Rinise, nga ana e zj. Eva Kushi, Ministre e kesaj Ministrie eshte urdheruar: *1. Miratimi i Statutit te KOKSH-it propozuar me vendimin e Asamblese se Pergjithshme te Jashtzakonshme dt. 10.01.2021, sipas tekstit bashkangjitur ketij urdheri (27 faqe). 2. KOKSH-i te ndjek procedurat e regjistrimit te statutit prane gjykates kompetente ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi. Statuti ekzistues i KOKSH-it, shfuqizohet.*

Po keshtu me shkresen Nr. 27/1 Prot. dt. 05.02.2021 te KOKSH-it, bashkangjitur eshte paraqitur shkresa dt. 02. 02. 2021 e Komitetit Olimpik Nderkombetar ne Lozane ne baze te se ciles ky Komitet ka informuar KOKSH-in se ne perputhje me Karten Olimpike (Rregulla 3.2) IOC ka aprovuar Statuin e rishikuar tuaj NOC (perkthim ne anglisht), siç eshte miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e KOKSH-it me dt. 10 janar 2021. Data e regjistrimit te ketij aprovimi eshte 2 shkurt 2021. Ne me mire si terheqim vemendjen tuaj per faktin se çdo ndryshim i mevonshem ne statutet tuaja te NOC (KOKSH) me iniciativen tuaj ose me kerkese te IOC, do te kerkoje gjithashtu miratimin e IOC.

Pikerisht keto vendime te marra ne kete Mbledhje te Asamblese se Jashtzakonshme te KOKSH-it te dt. 10 janar 2021 dhe akteve shoqeruese ne lidhje me to, kerkuesi, kerkon qe ti depozitoje prane regjistrin te OJF-ve me qellim dhenien e efekteve ligjore te tyre.

Neni 5 i Ligjit Nr. 8789 dt. 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese";: **Gjyqtari i vetëm.** 1. *Vendimi për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër, lidhur me veprimet që lidhen me regjistrimin e tyre, kryhen nga një gjyqtar i seksionit tregtar të gjykatës.* 2. *Gjyqtari ka të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve që kanë të bëjnë me Regjistrin, me përjashtim të atyre, që sipas ligjit kryhen nga Sekretari i Regjistrit.*

Neni 24 i Ligjit Nr. 8789 dt. 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese", përcakton se: 1. *Gjyqtari vendos për kërkesat e regjistrimit ose të depozitimit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në gjykatë.*

2. *Në rastin kur gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumentacionit të bashkëlidhur, gjyqtari vëren se përmbajtja e tyre nuk është e plotë, pasi thërret dhe dëgjon kërkuuesin, vendos për çështjet që duhen plotësuar, duke caktuar edhe një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.*

Ne kete kontekst dhe interpretim te kesaj dispozite (Neni 24/1) **akti procedural per gjykatën per vendimarrjen per depozitimn e ketyre akteve, sa me siper u shpjegua ne pjesën hyrese te vendimit, ka filluar ne dt. 08.02.2021.**

Perpos kesaj trupi gjykues pasi vistorj aktet, pasi studiova kërkesën dhe vendimet e siperpermendura si dhe praktiken e akteve te regjistrimit te kesaj shoqate ne referim te dispozites se mesiperme Neni 24/2 pare ne raport edhe me Nenet 154, 154/a te K.Pr.Civile, gjykata me vendimin e saj te ndermjetem dt. 10.02.2021 konstatoj te meta lidhur me kërkesen dhe aktet shoqeruese te saj te cilat ja beri prezent perfaqesuesit te KOKSH-it ne kete date, te meta keto qe konsistonin ne :

Se pari: A eshte mbledhur Komiteti Ekzekutiv per te marre vendim te posaçem ne baze te kërkeses se bere nga 2/3 te anetareve te Asamblese me te drejte vote, kerkese kjo e dt. 13.12.2020 per thirrjen e Asamblese se Jashtezakonshme? Nese po, a ka patur nje vendim nga Komiteti Ekzekutiv per caktimin e dates se mbledhjes, vendin e zhvillimit si dhe per njoftimin e anetareve te Asamblese, menyren e njoftimit ? Nese po duhet te paraqitet kopje e tij (vendimit), apo çdo akti tjetër qe lidhet me keto konstatime ?

Se dyti: Si jane kryer njoftimet per mbledhjen e Asamblese se Jashtzakonshem te dt. 10.01.2021 ?

Se treti: Referuar procesverbalit te mbledhjes se Asamblese se Jashtzakonshme te dt. 10.01.2021, ku citohet, faqe e pare e procesverbalit zv/Presidenti Vojo Malo, i cili drejtoi seancen e Asamblese, megenese Presidenti z. Bezhani nuk u paraqit...., si provohet se eshte njoftuar posaçerisht Presidenti i KOKSH-it, duke qene se rendi i dites se mbledhjes ka patur edhe si pike te tij, shkarkimin e Presidentit?

Se katerti: A jane verifikuar dhe nese po si verifikohet legjitimiteti i anetareve me te drejte vote qe kane nenshkruar kërkesen per thirrjen e Asamblese se Jashtzakonshme, pra nese keta individ jane perfaqesuesit legjitim te ketyre anetareve (subjekteve), kjo nepermjet ekstrakteve respektive te legjitimitetit te tyre si persona juridik/fizik, kjo ne referim edhe me dispoziten statutore, Neni 13/2 e statutit.

Se pesti: A eshte kryer e njehta procedure edhe me verifikimin e perfaqesuesve nominal prezent te anetareve te mbledhjes ne Asamblene e Jashtzakonshme ? A eshte kerkuar vendimi i organit

perfaqesues te anetareve qe kane nominuar perfaqesuesit e tyre ne mbledhje sipas percaktimit te Nenit 13/2 te statutit ?

Kjo per shkakun sepse per gjykatën nga verifikimi i listës së anetareve që kanë qenë anetare sipas akteve që kanë shoqëruar vendimin Nr. 5934 dt. 22.06.2018 të Gjykatës për regjistrimin e KOKSH-it, janë cituar gjithsej anetare Federata/Komitete Olimpikë dhe Shoqata gjithsej 47 anetare, ndërsa anetar me titull individual 9 persona. Pra në kushtet kur këto anetare janë cituar vetëm sipas statusit juridik të tyre dhe jo edhe emrat nominal të perfaqësuesve, atëherë në mbledhjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme a janë verifikuar perfaqësuesit nëse janë ata legjitim për çdo anetaresi, nëse kanë vendim të organit drejtues të tij/saj për qenien perfaqësues në mbledhje. Nëse po të paraqiten aktet perkatese paraprake të verifikimit që janë kryer nga Komisioni perkates ?

Se gjashti: Gjykata konstaton se formularët e akreditimit të paraqitur bashkë me kërkesën janë të gjithë akte (formular) që në përmbajtje referojnë dhe lidhen me thirrjen e Mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të dt. 18.12.2020 e cila si e tillë rezultoi të mos jete kryer pasi që është e pezulluar thirrja e saj me vendimin gjykatës Nr. 940 dt. 09.12.2020.

A ka formular akreditimi për thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme të mbajtur në dt. 10.01.2021, pasi që nuk mund të merren të mirqenë këta formularë që i perkasin një mbledhje tjetër (dt. 13.12.2020) për mbledhjen e (dt. 10.01.2021) !.

Se shtati: Referuar Nenin 15/2 të statutit, ky i fundit percakton se mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme mbidhet vetëm për vendimmarrje për ndryshimin e statutit, *si dhe për çështje të tjera me rëndësi të veçantë që kërkojnë vendimmarrje të shpejta*. Referuar vendimmarrjeve të Asamblesë, pse ka lindur si nevojë urgjente vendimmarrja për shkarkimin e Presidentit, pse është kjo një vendimmarrje me rëndësi të veçantë për këtë Asamble dhe si është motivuar ajo, pasi që në procesverbal nuk ka asnjë shpjegim shterues ?

Se teti: Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme nuk përjashton aspak procedurën normale paraprake të thirrjes së saj, rëndi i dities, vendimin e Komiteti Ekzekutiv, afatet e njoftimit, etj, njëlloj siç percakohen në nenin 13 të statutit.

Se nenti: Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Akreditimit dhe Votimit nuk është shumë e qartë për gjykatën mënyra e përlogaritjes së anetareve prezent për raport me anetaret në total si dhe numri i votave në raport me atë në total.

Për këtë qëllim me vendimin e sipercituar gjyqtari i vetëm vendosi që : *T'i caktojë kërkuessit, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar një afat deri më datë 18. 02. 2021 për plotësimin e të metave të kërkesës, në lidhje me gjithe konstatimet e sipercituara.*

Rezultoj se me shkresën Nr. 27/3 Prot. dt. 16.02.2021 e protokolluar në Gjykatë me Nr. 1270 Prot. dt. 17.02.2021 nga pala kërkuese u kthye përgjigje dhe u paraqiten provat që referoheshin në përgjigje dhe që konsistonin me këto përmbajtje:

Ne vijimesi të detyrave të lena nga gjykata, po japim disa sqarime për plotësim e të metave sa me sipër, kjo në vazhdim të punës tone udhëhequr nga parimet dhe vlerat olimpikë "Ekselence, Respekt dhe Miqësi" dhe të Qeverisjes së mirë në themel të të ciles është transparenca, këtu me poshtë dhe me dokumentat bashkëngjitur sqarojmë si vijon:

Se pari: Komiteti Ekzekutiv, pasi u njoh me kërkesën e 2/3 të Asamblesë së KOKSH në datë

15/12/2020 (emaili bashkangjitur se bashku me kerkesen), per shkak te pandemise dhe kohes se shkurter ne dispozicion, ka qarkulluar me email mendimet e anetareve dhe ka miratuar me shumice votash propozimin e Zv. Presidentit Z. Malo, duke vendosur ne date 24/12/2020 qe Asambleja e Jashtezakonshme e KOKSH te zhvillohet ne daten 10 janar 2021 (korrespondenca e anetareve te Komitetit Ekzekutiv dhe Vendimi bashkengjitur).

Se dyti: KOKSH, duke ndjekur edhe udhezimet e Komitetit Olimpik Nderkombetar ka kohe qe komunikimin me anetaret e realizon me ane te postes elektronike (e-mail), sidomos ne periudhen e pandemise. Njoftimet per mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te dates 10 janar 2021 jane kryer me ane te korrespondences elektronike me e-mail, ne daten 26 Dhjetor 2020 tek te gjitha anetaret e Asamblese se KOKSH. Ne daten 05/01/2021 jane njoftuar per vendin dhe oren, meqenese situata Covid e bente te pa mundur disponimin e ambienteve te pershtatshme per te garantuar te gjitha masat anti Covid. (per reference dokumentat bashkangjitur)

Se treti: Z. Bezhani eshte njoftuar posaçerisht lidhur me kete geshkje me ane te postes elektronike ne daten 28/12/2020, ku i kerkohet te shprehet edhe me shkrim (bashkelidhur njoftimi me e-mail). Ndersa qe ne daten 15/12/2020 ka qene ne dijeni te kerkeses se 2/3 te anetareve te Asamblese (ne te cilen kerkohet edhe shkarkimi i tij). Nderkohe, z. Bezhani ne pergjigje te njoftimit i drejtohet te gjitha Anetareve te Asamblese dhe Anetareve te Komitetit Ekzekutiv te KOKSH me ane te e-mail te derguar nga vete z. Bezhani ne daten 31.12.2020 (bashkelidhur e-mail z. Bezhani). Gjithashtu njoftimin e z. Bezhani per Asamblene dhe piken e rendit te dites, ate te shkarkimit te tij nga detyra e verteton edhe fakti qe ne daten 31.12.2020 ai ka paraqitur nje kerkese padi ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane me objekt "Pezullimin e Asamblese se dates 10.01.2021", kerkese e cila eshte rrezuar nga gjykata.

Se katerti: KOKSH mban komunikim te ngushte dhe te vazhdueshem me anetaret dhe nje saktesisht se cilet jane drejtuesit zyrtare te tyre. Per çdo ndryshim qe ndodh ne organet drejtuese te organizatave anetare te Asamblese KOKSH ka nje databaze te kontakteve qe e perditeson sa here ndodhin ndryshime te njoftuara nga vete anetaret. Administrata e KOKSH rregullisht njoftohet per çdo ndryshim qe behet jo vetem per President e Sekretar te Pergjithshem por edhe per anetaret e organeve drejtuese te anetareve te KOKSH. Formulari i Akreditimit eshte mandatimi i personave qe paraqitet nga adresat zyrtare te anetareve dhe me pas i vetmi verifikim qe behet perpara pjesemarrjes ne Asamble eshte paraqitja e dokumentit te identifikimit personal.

Se pesti: Sigurisht qe ne vendimin Nr. 5934, date 22.06.2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per regjistrimin e KOKSH-it duhej dhe jane cituar vetem personat juridik (Federata, Komitetet Olimpik Rajonale dhe Shoqatat) e nuk mund te shenoheshin perfaqesuesit e tyre, sepse keta perfaqesues jane te ndryshueshem ne periudha 4 apo me shume vjeçare sipas rregullave te tyre statutore. Verifikimi i anetareve dhe perfaqesuesve te tyre kryhet sipas shpjegimit te bere ne piken e katert ketu me siper dhe gjithashtu eshte kryer sipas listes se akreditimit qe anetaret kane paraqitur vete prane KOKSH.

Perfaqesuesve u jane verifikuar kartat e tyre te identitetit dhe ishin ne perputhje me akreditimin e derguar nga anetaret (me e-mail ose dorazi).

Me anetaret komunikohet me adresat e tyre elektronike autentike te konfirmuara ne kohe pergjate korrespondencave te vazhdueshme.

Ne lidhje me verifikimin e listes se anetareve, per vete ngjarjet shume dinamike te ndodhura ne KOKSH keto 3 vitet e fundit, duam te shtojme qe ne 21 Shtator 2019, po me kerkesen me shkrim te me shume se 2/3 te anetareve eshte mbajtur nje tjetër Asamble e Jashtezakonshme per te cilen eshte mbajtur

edhe nje procesverbal me vendimet perkatese. Vendimet e marra ne ate Asamble reflektojne edhe ndryshime ne listen e anetareve te KOKSH. Arsyeja pse nuk eshte depozituar ky procesverbal ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane eshte sepse z. Bezhani nuk ka dashur te firmosi procesverbalin dhe si perfaqesues ligjor te depozitonte ate ne Gjykate.

Ne lidhje me numrin e votave ne Asamble, sqarojme se ne baze te Statutit te KOKSH neni 17, pika 1.1 (qe ishte ne fuqi) Federatat dhe Shoqatat qe perfaqesojne nje sport ne programin Olimpik kane te drejten e dy votave (nje vote dhe nje vote suplementare), ndersa Federatat/Shoqatat qe nuk perfaqesojne sporte Olimpik dhe individet, kane te drejten e nje vote.

Se gjashti: Per Asamblene e Jashtezakonshme te dates 10/01/2021 nuk jane kerkuar formulare akreditimi te rinj, pasi ne Vendimin e Komitetit Ekzekutiv per caktimin e dates 10.1.2021 te Asamblese eshte e percaktuar shprehimisht (Pika 4) qe do te perdoren te njejtet formulare qe u derguan per Asamblene e dates 13 Dhjetor 2020, e cila u pezullua nga Gjykata me kerkese te Z. Bezhani (i cili edhe e kishte therritur kete Asamble). Federatat qe deri ne ate kohe kishin pesuar ndryshime ne akreditim, kane sjelle formulare te rinj akreditimi brenda afateve te kerkuara ose njoftim zyrtar per ndryshimet perkatese. Nuk ka asnje parashkrim apo pengese statutore apo ligjore qe te pengoje marrjen e vendimit per marrjen te mireqenja te formulareve te paraqitur vetem disa dite perpara. (Referohuni Vendimit te KE, Pika 4).

Se shtati: Ne baze te Statutit te KOKSH, organi me i larte vendimmarres eshte Asambleja e Pergjithshme. Ne kerkesen e dates 15/12/2020 eshte e percaktuar qarte se cfare kane kerkuar me shume se 2/3 e Anetareve te Asamblese se KOKSH, nder te cilat edhe shkarkimin e z. Bezhani. Nder te tjerat anetaret konstatojne qe Bezhani ka shkelur Rezoluten e dakordesuar dhe miratuar ne Asamblene e Jashtezakonshme te KOKSH ne date 09/02/2020, per ti dhene fund krizes institucionale ne KOKSH (Rezoluta e dates 09/02/2020 bashkangjitur). Referuar nenit 15/2 te statutit, mbas ndryshimeve statutore mendojme se nuk ka ceshetje me rendesi me te vecante se shkarkimi i nje presidenti. Shkaqet, arsyet dhe perse u shkarkua presidenti i KOKSH kete e dine dhe e kane vendosur vete me shume se 2/3 e anetareve, ne momentin qe kane percaktuar rendin e dites, te diet ashtu siç e zgjedhin ashtu edhe e shkarkuan.

Se teti: Procedura per zhvillimin e Asamblese se Jashtezakonshme eshte bere ne baze dhe respektim te afateve kohore te specifikuara ne statut. Gjithashtu, ajo lidhet me vendimin e Komitetit Ekzekutiv qe perfshinte orientime per akreditimet, afatet etj, duke respektuar kerkesen e 2/3 te Anetareve te KOKSH, e cila kishte percaktuar edhe rendin e dites.

Se nenti: Ne lidhje me numrin e votave ne Asamble, Federatat/Shoqatave qe perfaqesojne nje sport ne programin Olimpik kane te drejten e dy votave, ndersa Federatat/Shoqatat qe nuk jane sporte Olimpik dhe individet, kane te drejten e nje vote.

Ne listen e prezences dhe ate te votimit duket qarte ndarja se cilet kane te drejten e 1 dhe 2 votave (dokumenti i depozituar ne gjykate).

Pas kesaj shkrese kthim pergjigje (plotesim te metash) dhe akteve shoqeruese, pala kerkuese ka paraqitur nje shkrese tjeter me dt. 23.02.2021 "Plotesim sqarimi mbi kthimin e pergjigjes dt. 17.12.2021" ku nder te tjera citon se:

Ne vijimesi te Kthim pergjigje te dt. 17/02/2021 per depozitimin e Statutit dhe Akteve/Vendimeve te Asamblese se Jashtezakonshme te dates 10.01.2021 te KOKSH, po japim disa sqarime per plotesim te shkreses sa me siper, kjo ne vazhdim te punes tone udhehequr nga parimet dhe vlerat olimpik "Ekselence, Respekt dhe Miqesi" dhe te Qeverisjes se mire ne themel te te ciles eshte transparenca, ketu

me poshte dhe me dokumentat bashkengjitur sqarojme si vijon:

Se pari: Komiteti Ekzekutiv, pasi u njoh me kerkesen e 2/3 te Asamblese se KOKSH ne date 15/12/2020 (emaili bashkangjitur se bashku me kerkesen), per shkak te pandemise dhe kohes se shkurter ne dispozicion, ka qarkulluar me email mendimet e anetareve dhe ka miratuar me shumice votash propozimin e Zv. Presidentit Z. Malo, duke vendosur ne date 22/12/2020 qe Asambleja e Jashtezakonshme e KOKSH te zhvillohet ne daten 10 janar.

Ne lidhje me mungesen e Federates Shqiptare te Futbollit ne e-mailin perkatese, ka ardhur si rezultat i zbatimit te detyrimeve Statutore, pikerisht te nenit 11-HUMBJA E TE DREJTES SE ANTARSISE; dhe konkretisht te pikes 1.4.4 te ketij neni, mos pagimi te kuotizacionit vjetor te anetaresise.

Ku sikurse edhe vertetohet nga njoftimet perkatese bashkangjitur, Federata e Futbollit nuk ka paguar kuoten per 3 vjete rradhazi, vitet 2018, 2019 dhe 2020. Fakt ky, qe perligj mosnjoftimin e kesaj Federate.

Se dyti: KOKSH mban komunikim te ngushte dhe te vazhdueshem me anetaret dhe njej saktesisht se cilet jane drejtuesit zyrtare te tyre. Per cdo ndryshim qe ndodh ne organet drejtuese te organizatave anetare te Asamblese KOKSH ka nje databaze te kontakteve qe e perditeson sa here ndodhin ndryshime te njoftuara nga vete anetaret. Administrata e KOKSH rregullisht njoftohet per cdo ndryshim qe behet jo vetem per President e Sekretar te Pergjithshem por edhe per anetaret e organeve drejtuese te anetareve te KOKSH. I vetmi verifikim qe behet perpara pjesemarrjes ne Asamble eshte paraqitja e dokumentit te identifikimit personal.

Kjo vertetohet edhe nga dokumenti bashkangjitur, i printuar nga databaza e KOKSH; ku jane te saktuar antaret dhe adresat e komunikimit, si edhe numrat e kontaktit.

Eshte pergjegjesi personale e cdo anetari qe te paraqese formularin e perfaqesimit te firmosur e te vulosur nga Federata ose Shoqata si edhe kartat identitetit e perfaqesuesit.

Dokumentat e cituar me larte, i keni te bashkangjitur kesaj shkrese.

1. Databaza e antareve te KOKSH.
2. Njoftimet e Federates Shqiptare te Futbollit per kryerjen e pageses se kuotes per vitet perkatese.

Krahas sa me sipër, po kështu gjykata çmon te theksoje se nepermjet zyres se protokollit eshte vene ne dijeni per shkresen Nr. 1227 Prot. dt. 16.02.2017 te paraqitur nga z. Viron Bezhani me lende: shpjegime lidhur me kerkesen e pretenduar te KOKSH-it per depozitim te akteve, ku ne permbajtje te saj citon edhe njehere ne vija te pergjithshme parregullsise e kesaj mbledhje te Asamblese, kjo me te njejten permbajtje si dhe ajo e e-mailit te drejtuar anetareve te Komitetit Ekzekutiv dhe gjithashtu i ben me dije gjykates se eshte ne proces gjyqesor tjetër paralel lidhur me parregullsine e ketyre vendimmarrjeve.

Analiza e Gjykates

Nga ana e saj gjykata çmon se te theksoje se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: "gjykata që gjykon mosmarrëveshjen (çeshtjen) duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet". Nga ana tjetër Neni 16/1 i K. Pr. Civile percakton se: "gjykata zgjidh mosmarrëveshjen (çeshtjen) në përputhje me dipsozitat ligjore.... Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashitohen në padi

(kerkese), pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Nisur nga keto parime procedurale për aq sa ato vlejne ne kete proces, fillimisht perpara shqyrtimit te kerkeses dhe akteve te saj gjykata çmon te theksoje se ky proces gjyqësor për vet natyrën e tij është proces gracios (pa palë kundëstare) ç’ka do te thote qe gjykata gjykon e vetme, vetem mbi bazen e akteve qe jane paraqitur per shqyrtim nga pala kerkuese.

Gjykata vlerëson se natyra e këtij gjykimi është gjykim i posaçëm i një natyre të vërtetimit të faktit, ku gjykata vlerëson ligjshmërinë e vendimmarrjes së marrë nga organi vendimmarës i shoqates parë në raport me statutin e saj dhe ligjin për organizatat jofitimpruese.

Çdo person i tretë që pretendon palëgjshmërinë e kësaj vendimmarrje apo çdo të drejtë tjetër, ka të drejtën që në varësi të vendimmarrjes së gjykatës të mund të paraqesë kërkesë-padi, apo çdo lloj tjetër mjetei procedural në mbrojtje të interesave të veta personale në një gjykim tjetër me palë kundëstare.

Ky konstatim per gjykatën buron nga vet ligji Nr. 8789 dt. 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”, i cili i jep te drejten çdo pale te interesuar qe te kundeshtojte kete vendim.

Keshtu sipas nenit 18 te ligjit percaktohet se: *Në rastin kur, për shkak të shkeljes së ligjit, vërehet ose shpallet pavlefshmëria e një regjistrimi të bërë në Regjistër, ky regjistrim duhet të prishet me nënvizim, me kërkesën e të interesuarit ose kryesisht nga gjykata. Vendimi i gjyqtarit për të prishur me nënvizim një regjistrim u njoftohet palëve të interesuara. Kundër vendimit të gjyqtarit, pala e interesuar mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës.*

Neni 19 te ligjit percaktohet se: *1. Nëse një regjistrim duhet të prishet me nënvizim nga gjykata në zbatim të nenit 18 të këtij ligji, prishja bëhet duke regjistruar shënimin "Prishur me iniciativë dhe kompetencë". 2. Në rastet kur duhet të bëhet një regjistrim me iniciativë dhe kompetencë, ai duhet të pasqyrojë bazën ligjore dhe shënimin "Regjistruar me iniciativë dhe kompetencë", me përjashtim të rastiit të fillimit të procedurës së shlyerjes të dëmit ose të likuidimit në rrugë gjyqësore.*

Pas kalimit te këtij momenti procedural, sa me siper u parashtrua gjykata vlereson se kuadri ligjor qe rregullon kerkimet per depozitimet e akteve te organizatave jofitimpruese eshte ligji Nr. 8878 dt. 07.05.2001 “Per organizatat jofitimpruese” dhe Ligji Nr. Nr. 8789 dt. 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimpruese”,

Neni 16 i ligjit Nr. 8788 « Per organizatat jofitimpruese » percakton se : *.....Vendimet për ndryshime në aktin e themelimit, që kanë lidhje me emrin, simbolin, objektin, qëllimet, fushën e veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse, si dhe vendimet për transformimin e saj në një formë tjetër të një organizate jofitimprurëse, duhet t'i paraqiten gjykatës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij vendimi. Ndryshimet në aktin e themelimit i nënshtrohen të njëjtës procedurë të përdorur në rastin e regjistrimit fillestar të organizatës.*

Neni 18 i ligjit Nr. 8788 “Per organizatat jofitimpruese”, percakton se: *“Ndryshimi i statutit të shoqatës bëhet nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj. Në rast se statuti nuk parshikon një*

shumicë më të lartë votimi, ndryshimet në statut bëhen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të shoqatës. Në rastin e fondacionit dhe qendrave, organi më i lartë vendimmarrës i tyre, në përputhje me procedurat e përcaktuara në statut, ka në kompetencë të bëjë ndryshime në statut. Në rastin kur fondacioni është themeluar me akt testamentar, ndryshimi i vullnetit të testatorit nuk mund të bëhet kur kjo është e ndaluar shprehimisht në testament. Vendimi i mbledhjes së përgjithshme ose të organit më të lartë vendimmarrës të organizatës jofitimprurëse për ndryshimin e statutit, depozitohet në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, sipas procedurave të caktuara me ligj”.

Sa me sipër gjykata nisur nga ky kuader ligjor procedural dhe material, pasi vlerësoi në teresi të gjitha aktet e paraqitura nga pala kerkuese bashkë me kërkesën, shpjegimet shteruese të dhëna nga kjo pale pas konstatimit të të metave dhe provat bashkangjitur me to, çmon paraprakisht se ato janë të plota të paraqitura në formën e kerkuar nga ligji dhe të mjaftueshme për të vlerësuar gjykata mbi themelesinë e këtij kerkimi.

Në këtë kuptim gjykata mbi bazën e tyre konstaton se në teresi të gjitha procedurat e ndjekura për thirrjen e kesaj mbledhje të Asamblese së Jashtzakonshme, me tej e zhvillimit të saj në të gjithë komponentet lidhur me verifikimin e pjesëmarrjes, kuptimit të prezencës së nevojshme për zhvillimin dhe të kuorumit të nevojshëm për efekt të vendimarrjes, për natyrën e kesaj Asambleje, për me tej përputhshmëria e pikave të rendit të ditës në raport me ato që statuti përcakton dhe se fundmi çertifikimi i ligjshmerisë së statutit të ndryshuar nepermjet miratimeve formale nga autoritet kompetente si Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe po kështu dhe Komiteti Olimpik Nderkombëtar, vlerësohen për gjykatën si vendime të marra në përputhje me statutin e KOKSH-it dhe ligjin Nr. 8788 date 07. 05. 2001 “Per organizatat jofitimprurëse”.

Kështu, u provua për gjykatën se Komiteti Ekzekutiv në referim të nenit 15 të statutit është mbledhur për shkak të rregullave kufizuese të miratimit me akte normative nga KM, për shkak të pandemisë, në formën e komunikimeve online përsa i përket shqyrtimit të kërkesës për thirrjen e Asamblese së Jashtzakonshme të bërë nga 2/3 e anëtarëve me të drejtë vote. U provua se kjo kërkesë është bërë prezente anëtarëve të komitetit dhe pas marrjes së mendimit është nxjerrë një vendim qarkullues me rend dite të miratuar nga shumica që kanë shprehur mendim dhe që si i tillë ka prodhuar efekte. Në këtë kuptim për gjykatën është zbatuar dispozita statutore e KOKSH-it Neni 15 i tij për raport për atë që vlen me nenet 13, 14 të statutit lidhur me procedurën, afatet, rendin e ditës, etj.

Se dyti, u provua e plotësuar e meta e dytë e konstatuar lidhur me mënyrën e thirrjes së anëtarëve për mbledhjen e Asamblese së Jashtzakonshme nepermjet e-mailit të dt. 26.12.2020, si dhe e-mailit dt. 05.01.2021.

Se treti, u provua se është plotësuar edhe e meta e tretë e konstatuar në lidhje me njohimin e Presidentit të KOKSH-it z. Bezhani nepermjet e-mailit dt. 28.12.2020 dhe kthimit të përgjigjes nga ana e tij po nepermjet e-mailit dt. 31.12.2020, si dhe për raport me të metën e konstatuar se shtati në vendimin e dt. 10.02.2021 u provua dhe rendesia e kesaj pike të rendit të ditës se propozuar.

Se katërti dhe se pesti, u provua dhe shpjegua për gjykatën në mënyrë shteruese nga të dy kthim përgjigjet mënyra e verifikimit të legjitimitetit të anëtarëve me të drejtë vote të KOKSH-it sipas përcaktimeve statutore dhe rregulloreve të brendshme të KOKSH-it (shiko për më tepër pikat: se katërti, se pesti në shkresën e dt. 16.02.2021 dhe pikat se pari, se dyti në shkresën dt. 23.02.2021, plotësim përgjigje).

Se gjashti, u provua per gjykatën se me vendimin qarkullues te Komitetit Ekzekutiv (diskrecionalitet i saj ligjor) referuar e-mailit dt. 22.12.2020 lidhur me formularet e akreditimit eshte disponuar per ekuivalencen e tyre per mbledhjen e Asamblese se dt. 10.01.2021 edhe pse jane formularë per nje mbledhje te meparshme te pa zhvilluar.

Ne fundmi, u shpjegua qartesisht nga pala kerkuese per gjykatën edhe pesha specifike e votes se anetareve me te drejte vote dhe menyra e perlllogaritjes se saj, sipas se ciles Federatat/Shoqatave qe perfaqesojne nje sport ne programin Olimpik kane te drejten e dy votave, ndersa Federatat/Shoqatat qe nuk jane sporte Olimpikë dhe individët, kane te drejten e nje vote.

Ne teresi keto shpjegime dhe provat respektive sa me siper u shpjegua perligjin vendimmarrjet respektive ne aspektin formal dhe procedural te tyre.

Ne kete menyre gjykata perfundimisht e gjeti kete kerkese te saj te drejte, te bazuar ne ligj dhe ne statut te tij dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr. 8788 date 07. 05. 2001 dhe Ligjit Nr. 8789 date 07. 05. 2001 si dhe dispozitave te Kodit Civil,

VENDOSA :

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimim ne Rregjistrin e Organizatave Jofitimprurese te vendimeve te Asamblese se Jashtzakonshme te KOKSH-it te dt. 10 Janar 2021 dhe ndryshimeve statutore te miratura ne kete Asamble.
3. Urdhrohet, Zyra e Regjistrimit të OJF-ve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të kryej veprimet përkatëse për regjistrimin e këtij vendimi dhe depozitimim e akteve.

- Tirane me dt. 01. 03. 2021.

GJYQTARI

ERVIN POLLOZHANI

Tabela e shpenzimeve

Taksë regjistrimi	1.000 lek
Totali	1.000 lek



100